

PLASA VAPE

Gratë në paravijën e një
planeti që digjet





Kriza klimatike po kthehet në pjesëmarrëse aktive në jetët tona dhe kur mendon se nën të njëjtin diell digjemi të gjithë njësoj? Sigurisht që jo! Gratë kanë nderin të jenë në paravijën e kërcënimit edhe këtë herë, sepse të mbash peshën e përkujdesjes për një familje të tërë, kombinuar me pabarazitë e vazhdueshme në çdo fushë të jetës, sigurisht që nuk mjafton.



TË



MBYTESH

PA



ASNJË

PIKË



UJË





E keni parasysh që në shumë
vende në zhvillim, gratë
kanë përgjegjësinë për të
gjetur ujë, për të bërë
gjëra qejfi sigurisht,
si larja e rrobave,
enëve, gatimi.




Sa më e vështirë bëhet kjo detyrë,
kur lumenjtë janë kujtime të
largëta, të pluhurosura?



MBIJETESA **NIVEL EKSPERT**





MENDON SE JANË PROBLEME TË NJË BOTE
MË PAK TË ZHVILLUAR SE E JONA?

40% e grave në Shqipëri janë të punësuar në bujqësi dhe kur të mbjellat shterojnë për shkak të thatësirave apo përmbytjeve, një jetë që është tashmë e vështirë, gjen mënyrën për t'u vështirësuar edhe më shumë.



A E

DI

SE


PO

NDODH

BRENDANESH?

NESH?





Jo, nuk është një thënie bajate
motivuese, rritja e temperaturave
ndikon në shëndetin riprodhues.
Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë e
rritjes së temperaturave me lindjet e
parakohshme në 20 vitet e fundit.

Kur e pyetën studjuesen pse u desh kaq
kohë për të bërë lidhjen mes temperaturave
dhe lindjeve të parakohshme, përgjigja
ishte kjo:

**SEPSE
GRATË
JANË**

**TË
FUNDIT QË
STUDIOHEN**


An illustration of a person from the back, wearing a red short-sleeved shirt with a pink grid pattern. The person's hands are on their hips, and their legs are spread apart. The style is simple and graphic, with thick black outlines for the limbs and a textured, hand-drawn appearance for the shirt. In the top left corner, there are some red brushstrokes.

TAKSIRATI I TË PATURIT MITËR



bashkë
në të mirë
e në të keq?

Në raste të fatkeqësive natyrore, dhuna ndaj grave rritet ndjeshëm. Sepse asgjë nuk thotë “zemër, je gjithçka për mua” si të qenit shënjestra e shfryrjes në ditë të vështira.



Duket sikur universi ka një sens
të çuditshëm humori që, kur
digjet planeti, marrin flakë dhe
të drejtat e grave.

**FSHATI
DIGJET
“LIDERËT”
KRIHEN**

P
FAT
3

Goca pa merak! Bota ka një plan.

Do vazhdojmë me këto konferencat

ndërkombëtare, ku mbizotërojnë

liderët burra që flasin për

“përqasje me ndjeshmëri gjinore”.

Sepse asgjë nuk tregon progres si

një dhomë plot me burra, që

diskutojnë çfarë u duhet grave me

termat më të vagullt të mundshëm!

Kjo ishte veç një pjesë e peizazhit të vunerabilitetit të grave ndaj krizës klimatike, e ndërkohë që kjo krizë duket se po kthehet në normalitetin tonë të ri dhe duket se nuk mund të bëjmë (ose nuk duam të bëjmë) shumë për ta kthyer mbrapsht, kam një ide të çmendur! Po sikur t'u japim grave të drejta bazike njerëzore? Ti fuqizojmë të marrin vendimet e tyre financiare për të ardhmen e tyre. Të krijojmë një sistem shëndetësor që dëgjon dhe adreson problemet e tyre dhe nuk i trajton si të fundit në listë.

E nëse dhe kjo është e tepërt, minimalisht të jemi aty me mendje dhe veshë të hapur për të dëgjuar historitë e grave dhe vajzave, që po përballen me këto probleme, në vend që të shohim nga ana tjetër duke përshpëritur "një tjetër gjë që gjetën për t'u ankuar."

Ja pra ku jemi me krizën e klimës, që në larjen e hesapeve, gjen mënyrën të jetë pak më e ashpër me gratë. Fundja, kështu e do zakoni!